

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Elbasani në Delvinë, 15 bashki nisin regjistrimin e pasurive, çelet tenderi 3.5 mln euro
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/ekonomi/nga-elbasani-ne-delvine-15-bashki-nisin-regjistrimi-n-e-pasuriv-i1185623
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:17:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 14:32:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	53c4ffd132fb5398380e41a276fa87d962cd27c98ff6bb9dc845fe7990c9f93b
TEKSTI	a7dc2c26b4779f364f9377025a988591db5704272f077d5e032bb5ec05933dc9
PAMJA	b7af8cc955a0b221a366e1e4ffb0d31acce2e64b6b86430b5e479a9d7d51b444

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3353ecc782ae033c328a399722ecb26d09632299338129cfb4f9f3ba1001d7fe
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3353ecc782ae033c328a399722ecb26d09632299338129cfb4f9f3ba1001d7fe>


PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Nga Elbasani në Delvinë, 15 bashki nisin regjistrimin e pasurive, çelet tenderi 3.5 mln euro

Nga Marjo Brakaj
22 Shtator 2026, 16:32 | Ekonomi



Nga Elbasani në Peqin, bashkë me Durrësin, Lushnjën e Patosin, për të vijuar në Vlorë, Delvinë e Finiq... Në 15 bashki të vendit do të nisë regjistrimi fillestar i pronave.

Në Agjencinë e Prokurimit Publik është çelur tenderi me vlerë 337.6 milionë lekë, ose rreth 3.5 milionë euro, për zhvillimin e këtij procesi.

"Në pamundësi të burimeve njerëzore dhe kohës në dispozicion, procedura do të bëhet nga privati. Kjo është një ndërhyrje e gjerë teknike, që kërkon ekspertizë të specializuar dhe kapacitete që institucionet nuk i kanë aktualisht në masën e nevojshme."

Kompanitë që do të fitojnë tenderin do të duhet të realizojnë punime topografike, përgatitjen e hartave, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave kadastrale të pasurive, digjitalizimin e informacionit mbi pronat, kontrollin e cilësisë së të dhënave, arkivimin e tyre, si dhe përpunimin e të dhënave gjeohapësinore. Ky proces lidhet edhe me detyrimet që rrjedhin nga negociatat për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

"Është pjesë e kapitujve të negociatave mbi pronësinë dhe përbën një nga proceset që Shqipëria duhet ta çojë përpara për të harmonizuar sistemin e saj me standardet evropiane. Pa një bazë të plotë dhe të besueshme të të dhënave, zgjidhja e problematikave të pronësisë mbetet e vështirë."

Regjistrimi fillestar është një proces me rëndësi të veçantë për administrimin e pronës në Shqipëri, pasi synon të krijojë një pasqyrë të plotë dhe të formalizuar të pasurive të paluajtshme dhe të të drejtave mbi to. Një regjistrim i saktë dhe i përditësuar ndihmon në qartësimin e kufijve dhe statusit juridik të pronave, reduktimin e pasigurive dhe konflikteve, si dhe në përmirësimin e shërbimeve kadastrale.

"Ky proces është shumë i rëndësishëm edhe për qytetarët, sepse një pasuri e regjistruar dhe e dokumentuar qartë ka më shumë siguri juridike. Në praktikë, kjo ndikon edhe në transaksionet, investimet dhe mundësinë për ta përdorur pronën në mënyrë të ligjshme dhe të sigurt."

Në një vend si Shqipëria, ku çështjet e pronësisë dhe dokumentacioni kadastral kanë qenë prej vitesh një problem kompleks, përfundimi i regjistrimit fillestar në zona të ndryshme të territorit përbën një hap të rëndësishëm drejt një sistemi më të rregullt dhe më transparent të administrimit të pronës. **(A2 Televizion)**

TE FUNDIT

SHBA ndërton dy baza të reja ushtarake në Groenlandë, zbulohen detaje nga marrëveshja e Trump

Vendi i NATO-s i jep dritën jeshile armëve bërthamore, Rusia paralajmëron pasoja

Zjarr i përmasave të mëdha në Gjirin e Lalzit, flakët përhapen me shpejtësi

Balla pas shkarkimit të Vlorë Hysenit: PS nuk bën avokatit e askujt

MË TË VIZITUARAT

"Te SPAK-u s'ka më njeri imunitet", gazetari: Është dhënë visto nga ndërkomb...

"Minë me sahat", Qafoku nxjerr shifrat: Rama ndërron 3 ministra të Brendshëm ...

Aksident në Lezhë, humbet jetën 50-vjeçari

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



15 masa për ndryshim, tregu i pasurive në informalitet, një në tre agjentë pa licencë



557 miliardë lekë deri në gusht, shteti mbledh më shumë, por paratë mbeten në arkë



Pavarësisht "diellës" apo "yllit", gati 40 mijë të punësuar në bashki, 2-fish më tepër se në 2014



Bordi i Transparencës cakton çmimet e reja të karburanteve



Nafta fik traktorët, fermeri habitet nga çmimi: Po e blejmë njësoj si makinat luksoze



Risi në zhdoganimin e automjeteve, Dogana miraton manualin: Ja si do të llogaritet vlera e makinave

Latest Videos





“Turp, video perversitetit në zyrën e Ramës” Poli Hoxha bën paralajmërimin: Prisni se ç'do të plasë



“Kush po tradhton Ramën?” Gazetarët debat të fortë me Arjan Ndojën: Trego çfarë i ke borxh Berishës



“Goditja e fortë bie shteti” Debate në studio, Arjan Ndoja bën denoncimin: Çfarë po ndodh me postat?



“Ngjarje shumë e rëndë”, Qafoku: Si e rrëzoi shtetin e Kosovës dhe Shqipërisë kryespiunja Hyseni

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulohet
Imagjinatë
Dëshmi



Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësiuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.